

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid



Raport Muaji Mars 2026

Fondi Furnizues Raiffeisen Solid

Informacion bazë

Emri i fondit
Administrimi i Fondit
Monedha
Datë Lancimi
Vlera fillestare e kuotës
Shuma minimale e investimit
Shuma fillestare minimale per plan investimi
Fondi Kryesor ku investon
Vlera Neto e Aseteve
Cmimi i kuotës
Banka depozitare
Banka nëndepozitare
Numri i Investitorëve
Horizonti minimal i rekomanduar i investimit
Kthimi vjetor nga investimi në 31 Mars 2026

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid – Fond Furnizues Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a

Euro
07 Maj 2024
100
€ 500
€ 50
Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide – ISIN AT0000A1YC10
€ 2,300,425
101.8568
Banka e Pare e Investimit, Albania
Raiffeisen Bank International, Austria
116
5 vjet
+0.05%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje 0.00%
Tarifë në dalje 1.00% për çdo tërheqje përpara periudhës 2-vjeçare të investimit
Tarifë administrimi vjetore Deri në 1.30% në vit
Tarifa te tjera te vazhdueshme Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Total Komisione/tarifa të vazhdueshme 1.58% per vitin 2025 ne 31.12.2025
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe bankes depozitares.

Objektivi dhe Politika e investimit e Fondit Furnizues


Objektivi i Fondit Furnizues është t'ju mundësojë investitorëve të përfitojnë nga kthimi i Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide, i cili synon krijimin e të ardhurave të rregullta në një periudhë afatmesme.

Fondi Furnizues investon në kuotat e Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide të paktën 85% te asetëve. Jo më shumë se 15% e asetëve do të investohen në instrumente si depozita bankare afatshkurta, marrëveshje të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, cash apo ekuivalentë të tij.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Potencial Përfitimi më i ulët

Risk i lartë
Potencial Përfitimi më i lartë



Profili i parashikuar i riskut të Fondit Furnizues është i lidhur ngushte me profilin e riskut të Fondit Kryesor. Bazuar në të dhënat historike të kthimeve të Fondit Kryesor gjatë 5 viteve të fundit, profili i parashikuar i riskut të Fondit Furnizues i përket kategorisë 3 të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit (SRRI=3).

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen

Fondi Kryesor Raiffeisen Solid

Informacion bazë

Emri i fondit	Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H, Austria
Monedha	Euro
ISIN	AT0000A1YC10
Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	0.50%
Rabat i paguar Fondit Furnizues	0.306% në vit

Politika e Investimit

Fondi Kryesor është një Fond miks që investon në tituj, emetuesit e të cilëve janë klasifikuar si **të qëndrueshëm në bazë të kriterëve sociale, mjedisore dhe të qeverisjes** (pa marrë parasysh investimet në fonde investimi, instrumentet derivative dhe depozitat). Sipas këtyre kriterëve, nuk investohet në sektorë të caktuar, të tillë si prodhimi i armëve, inxhinieria gjenetike e gjelbër/bimëve, në kompani që shkelin të drejtat e punës dhe të njeriut, ose që janë të përfshira në korrupsion dhe manipulim të pasqyrave financiare, ne shtete me regjime autoritare, ku shkelet liria e medias dhe shtypit, apo që nuk janë pjesë të marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike apo kanë problematika të lidhura me pastrimin e parave.

Fondi Kryesor e ka kufizuar investimin në aksione deri në 30% të aseteve të tij. Të paktën 51% e aseteve të Fondit Kryesor investohen drejtpërdrejt në tituj. Emetuesit e obligacioneve ose instrumenteve të tregut të parasë në Fond mund të jenë, ndër të tjera, shtetet, organizatat supra kombëtare dhe/ose kompanitë. Fondi Kryesor mund të investojë më shumë se 35% të aseteve në tituj borxhi të emtuar nga qeveria e Austrisë, Gjermanisë, Belgjikës, Finlandës, Francës ose Holandës.

Fondi Kryesor mund të investojë në instrumente derivative si pjesë e strategjisë së tij të investimit, me qëllimin për të zbutur risqet dhe për të arritur objektivat e politikës së investimit.


Struktura e Portofolit të Investimit në 31 Mars 2026

Fondi Furnizues ka investuar 95.43% të aktiveve të tij në Fondin Kryesor në 31 mars 2026.


Duke marrë parasysh strukturën e portofolit të investimeve të fondit Kryesor më 31 mars 2026, për fondin Furnizues alokimi në aksione është 18.22% dhe alokimi në instrumentet me të ardhura fikse është 79.88%.

Vlerësimi mesatar i riskut të kreditit është A për investimet në obligacione të fondit Kryesor. Yield-i mesatar i portofolit të investimeve ishte 3.76% për një kohëzgjatje mesatare prej 4.94 vitesh në 31 mars për fondin Furnizues.

Sipas instrumentave financiare



Sipas klases se aseteteve



Investime ne Obligacione Top 10 – Fondi Kryesor

BPIFRANCE SACA BPIFRA 3 3/8 05/25/34	1.79%
NVIDIA CORP NVDA	1.14%
CAISSE D'AMORT DETTE SOC CADES 0 1/8 09/15/31	1.10%
REPUBLIC OF AUSTRIA RAGB 0.9 02/20/32	0.95%
EUROPEAN UNION EU 0 07/04/31	0.92%
ALPHABET INC-CL A GOOGL	0.90%
APPLE INC AAPL	0.89%
LAND HESSEN HESSEN 2 1/2 10/01/31	0.88%
CAISSE D'AMORT DETTE SOC CADES 0.6 11/25/29	0.82%
BONOS Y OBLIG DEL ESTADO SPGB 3.9 07/30/39	0.74%

Info per Obligacionet – Fondi Kryesor


Ø Kohëzgjatja	5.18
Ø Kohëzgjatja e modifikuar	5.01
Ø Yield në % (në maturim)	4.03
Ø Yield në % (Next call)	3.94
Ø Norma e kuponit në %	2.68

Investime ne Aksione top 10 - Fondi Kryesor

NVIDIA Corp	1.21%
Alphabet Inc	0.91%
Apple Inc	0.91%
Microsoft Corp	0.66%
Amazon.com Inc	0.43%
Broadcom Inc	0.38%
JPMorgan Chase & Co	0.33%
Motorola Solutions Inc	0.27%
Eli Lilly & Co	0.25%
ASML Holding NV	0.24%

Performanca e Fondit Furnizues

Fondi Furnizues ka shënuar një ecuri negative mujore prej **-2.85%** gjate muajit mars. Obligacionet qeveritare globale pësuan rënie, pasi rritja e çmimeve të energjisë shtyu më lart pritshmëritë për inflacionin dhe detyroi investitorët të rishikojnë perspektivën e normave të interesit në nivel global. Tregjet globale të aksioneve ranë ndjeshëm në mars, me Azinë dhe Europën që udhëhoqën këtë rënie pas një fillimi viti tejet premtues.



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit të Qendrueshem Raiffeisen Solid dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfutur nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situatat jo te zakonshme te krijuara perkohesisht në tregjet financiare, sepse ne kete menyre nuk do te riskojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Komenti i Menaxherit të fondit Kryesor mbi zhvillimet e tregjeve financiare gjatë Marsit

Tregjet ndërkombëtare të aksioneve performuan negativisht në muajin mars. Arsyeja kryesore për këtë ishte sulmi i SHBA-së dhe Izraelit ndaj Iranit. Rritja e çmimeve të naftës si pasojë e këtij zhvillimi, ndikoi negativisht në rritjen ekonomike, veçanërisht në Europë dhe Azi, dhe çoi në rritje të pasigurisë. Edhe tregjet e obligacioneve pësuan rënie të konsiderueshme në mars. Obligacionet e korporatave u përballën me rritje të mëtejshme të yield-eve në një mjedis ku pritshmëritë për inflacionin u rritën ndjeshëm dhe rritjet e normave të interesit tashmë ishin të reflektuara në çmime. Në këtë situatë, fondit pati një performancë negative në tërësi.

Fondi kryesor investon duke siguruar diversifikim të gjerë në obligacione dhe aksione të kompanive dhe qeverive që respektojnë kriteret e qëndrueshmërisë.

Performanca në muajt e ardhshëm do të varet kryesisht nga zhvillimet e konfliktit në Lindjen e Mesme, sezoni i raportimeve financiare dhe masat e mëtejshme të bankave qendrore.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit Furnizues. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit Furnizues gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.

Dokumentacionin e fondit Kryesor mund ta gjeni në gjuhën angleze dhe gjermane duke klikuar si më poshtë:

<https://www.rcm.at/at-en/retail/funds/detail/Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide>

<https://www.rcm.at/at-en/retail/funds/detail/Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide>